

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi

**Pasqyrat Financiare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015**

PERMBAJTJA:	Faqe
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	5
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE	6
SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE	7-15

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2015
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

AKTIVET	Shenime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET AFATSHKURTRA			
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	4	29,179	8,812
Llogari financimesh te brendshme	5	752,644	3,897,626
Te drejta te arketueshme	6	443,040	135,783
Aktive te tjera afatshkurtra	7	237,086	3,067
Inventari	8	811,133	766,348
		2,273,083	4,811,635
AKTIVET AFATGJATA			
Aktive kerkimi dhe vleresimi	9	18,884,019	18,725,369
		18,884,019	18,725,369
TOTALI I AKTIVEVE		21,157,102	23,537,005
DETYRIMET DHE KAPITALI			
DETYRIMET AFATSHKURTRA			
Llogari te pagueshme	10	142,447	496,201
Detyrime tatimore	11	19,358	20,021
Detyrime ndaj paleve te lidhura	12	571,948	187,981
		733,753	704,203
DETYRIMET AFATGJATA			
Fonde nga Shoqeria Meme	13	36,982,260	33,877,620
		36,982,260	33,877,620
TOTALI I DETYRIMEVE		37,716,013	34,581,823
KAPITALI			
Humbje te mbartura		(11,044,818)	(5,257,633)
Humbja e vitit		(5,514,093)	(5,787,184)
		(16,558,911)	(11,044,819)
TOTAL I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		21,157,102	23,537,005

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto Pasqyra Financiare jane miratuar nga perfaqesuesi ligjor i Shell Upstream Shqiperi B.V. - Dega ne Shqiperi, me 31 Tetor, 2016.

Miratuar nga: Turker Sengonul, Perfaqesues Ligjor




SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Pasqyra e Performances Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(te gjitha shumtat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE

	Shenime	2015	2014
Te ardhurat	14	<u>4,117</u>	<u>26,573</u>
Shpenzime te aktivitetit operativ			
Shpenzime personeli	15	(641,829)	(401,083)
Shpenzime operative	16	(2,139,644)	(2,380,922)
Shpenzime te tjera	17	(1,998)	(616)
Totali i shpenzimeve te aktivitetit operativ		<u>(2,783,471)</u>	<u>(2,782,621)</u>
Humbja operative		<u>(2,779,354)</u>	<u>(2,756,048)</u>
Shpenzime financiare		(10,754,478)	(5,189,432)
Te ardhura financiare		8,019,739	2,158,296
Humbja financiare neto	18	<u>(2,734,739)</u>	<u>(3,031,136)</u>
Humbja para tatimit		<u>(5,514,093)</u>	<u>(5,787,184)</u>
Shpenzimi per tatimin mbi fitimin	19	-	-
Humbja e vitit		<u>(5,514,093)</u>	<u>(5,787,184)</u>
Te ardhura te tjera gjithepershireshe neto pas tatimit mbi fitimin		-	-
Humbja gjithepershireshe e vitit per Degen		<u>(5,514,093)</u>	<u>(5,787,184)</u>

Pasqyra e Performances Financiare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

TS

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V. – Dega ne Shqiperi
Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

	Humbje te mbartura	Kapitali total
Gjendja me 1 janar 2014	(5,257,634)	(5,257,634)
Humbja e vitit	(5,787,184)	(5,787,184)
Te ardhura te tjera gjithepershires	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2014	(11,044,818)	(11,044,818)
Gjendja me 1 janar 2015	(11,044,818)	(11,044,818)
Humbja e vitit	(5,514,093)	(5,514,093)
Te ardhura te tjera gjithepershires	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2015	(16,558,911)	(16,558,911)

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

TS

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi
Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke)

PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE

	2015	2014
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin operativ		
Humbja e vitit	(5,514,093)	(5,787,184)
<i>Rregullime per:</i>		
Te ardhura nga interesi	(575)	(12)
Humbja operative para ndryshimeve ne kapitalin punues	(5,514,668)	(5,787,196)
Ndryshimi ne inventar	(44,786)	(85,599)
Ndryshimi ne te drejtat e arketueshme	(307,257)	159,749
Ndryshimi ne aktivet e tjera afatshkurtra	(234,020)	626,422
Ndryshimi ne llogarite e pagueshme	(353,754)	(457,731)
Ndryshimi ne detyrimet tatimore	(662)	19,972
Ndryshimi ne detyrime ndaj paleve te lidhura	383,966	19,579
Mjete monetare neto perdorur ne veprimtarine operative	(6,071,181)	(5,504,804)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e investimit		
Kostot e kerkimit dhe vleresimit	(158,650)	(6,585,780)
Interesa te marra	575	12
Mjete monetare neto perdorur ne veprimtari investuese	(158,075)	(6,585,767)
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetet e financimit		
Ndryshimi ne llogarine e financimeve te brendshme	3,144,983	(3,883,356)
Fonde te marra nga Shoqeria Meme	3,104,640	15,980,818
Mjete monetare neto nga veprimtaria financuese	6,249,623	12,097,462
Rritja neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	20,367	6,890
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne 1 janar	8,812	1,922
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne 31 dhjetor	29,179	8,812

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 7 deri ne 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

TS

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

Shell Upstream Albania B.V. – Dega ne Shqiperi (referuar ketej e tutje si "SUA" ose "Dega") eshte dege e Shell Upstream Albania B.V., themeluar ne Hollande (referuar si "Shell" ose "Shoqeria Meme"), filial i shoqerise shumekombeshe te naftes dhe gazit Royal Dutch Shell plc. Dega eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me 7 qershor 2012, ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me numer unik identifikimi tatimor (NIPT) L218070091. Numri i punonjesve te Deges me 31 dhjetor 2015 eshte 11 (31 dhjetor 2014: 20).

Aktiviteti kryesor i Deges eshte shpimi ne kerkim per hidrokarbure ne Shqiperi. Me 9 shkurt 2012, Shell hyri ne Shqiperi duke marre 50% te Interesit Punues ne Blloqet 2-3, ne ate kohe nen operim nga Petromanas Albania GmbH (PMI) permes nje Kontrate me Ndarje Prodhimi (KNP) me qeverine shqiptare. Shell e zgjeroi me tej Interesin Punues ne 75% ne vitin 2013. Nje fushate shpimi, kerkimi dhe vleresimi sizmik qe perfshinte hapjen e 4 puseve per 3 vite, nisi me hapjen e Shpirag-2. Zbulimi i rendesishem permes Shpirag-2 ne vitin 2013 ri-konfirmoi potencialin e parashikuar ne Blloqet 2-3. Si rezultat i uljes se cmimit te naftes, PMI (me poshte referuar edhe si "Ortak ne Siper marrje te Perbashketa") u ndesh me veshtiresi financiare ne tre-mujorin e dyte te vitit 2014 dhe vendosi ne shitje te gjitha interesat e tij ne Shqiperi ne nentor 2014. Siper marrja e perbashket nuk pati aktivitet operacional, nderkohe qe PMI u perpoq te shese interesat e tij ne Shqiperi ne vitin 2015. Ne shkurt 2016, Shell dhe PMI arriten nje marreveshje, sipas se ciles Shell bleu interesat e mbetura te PMI ne Shqiperi duke marre 100% te interesit kontrollues dhe te drejten e operimit ne Blloqet 2-3.

Operacionet e shpimit ne pusin Shpirag-3 filluan me 5 qershor 2016 ne perputhje me kerkesat e KNP-se.

Ne vitin 2015, pas nje procedure konkurruese licensimi, SUA-s iu akorduan ne menyre te kushtezuar interesat ne Bllokun 4. Negociatat ne lidhje me finalizimin e KNP-se se re jane ne proces e siper.

2. BAZAT E PERGATITJES

2.1 Deklarata e perputhshmerise

Keto pasqyra financiare jane pergatitur ne perputhje me Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", te ndryshuar, dhe ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi te publikuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit ne Shqiperi dhe te permiresuara me efekt nga 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte njekohesisht dhe monedha funksionale e Deges. Te gjitha vlerat jane rrumbullakosur ne te mijten me te afert, pervec se kur eshte percaktuar ndryshe.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

2.4 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit e Deges te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Deges dhe ne raportimin e te gjitha vlerave te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje nga keto vleresime. Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar, si dhe ne periudhat e ardhme qe preken. Informacioni mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve, pasigurise dhe gjykimeve kritike ne zbatimin e politikave kontabel ne keto pasqyra financiare eshte perfshire ne shenimet vijuese.

2.5 Ndryshimet ne politikat kontabel

Siç percaktohet ne shenimin 2.1, keto pasqyra financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te permiresuara te Kontabilitetit, me aplikim prospektiv nga 1 janari 2015. Standardet Kombetare te permiresuara te Kontabilitetit dhe efektet mbi politikat kontabel specifike jane zbatuar ne daten e raportimit. Shumat krahasuese nuk jane rivleresuar, por vlera te caktuara te vitit te kaluar jane riklasifikuar per t'iu pershtatur paraqitjes ne vitin aktual. Ndryshimet ne politikat kontabel nuk kane patur efekt mbi vlerat e raportuara te aktiveve dhe detyrimeve ne keto pasqyra financiare.

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te meposhtme jane zbatuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare.

3.1 Operacionet e perbashketa

Llogarite e SUA reflektojne perqindjen e interesit pjesemarres ne aktivitetet e kerkimit dhe vleresimit te naftes dhe gazit sipas KNP-se per Blloqet 2-3 ne toke ne Shqiperi, qe jane kryer nga Dega Shqiptare e Petromanas Albania GmbH, ne cilesine e Operatorit ne Marreveshjen e Operacioneve te Perbashketa me SUA.

3.2 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit, ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehene ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit njihen pergjithesisht ne fitime ose humbje.

Kursi i kembimit i monedhave te huaja me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 eshte detajuar si me poshte:

Kurset e kembimit	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
LEK/EUR	137.28	140.14
LEK/USD	125.79	115.23

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

3.3 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare jo-derivative perbehen nga te drejta te arketueshme, mjete monetare dhe ekuivalente te tyre, llogari te financimeve te brendshme, llogari te pagueshme, detyrime ndaj paleve te lidhura dhe ndaj Shoqerise Meme.

Te gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht me vleren e drejte plus cdo kosto transaksioni qe lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative njihen sic pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojne te drejta kontraktuale te Deges mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur Dega transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbeshore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Dega angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Deges skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat bankare. Per qellimin e pasqyres se flukseve te mjeteve monetare, mjetet monetare perfshijne depozita me afat maturimi prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen me koston e amortizuar ne pasqyren e pozicionit financiar.

Llogarite e financimit te brendshem

Llogarite e financimit te brendshem paraqesin gjendjen e mjeteve monetare te grumbulluara nga shoqerite e grupit dhe te vena ne dispozicion per Degen. Ato mbarten me kosto te amortizuar ne pasqyren e pozicionit financiar.

Te drejta te arketueshme

Te drejta te arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjioni per zhvleresimin e te drejtave te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Dega nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejta te arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigjionit eshte llogaritur si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve monetare te ardhshme te skontuara me normen e interesit efektiv.

Llogarite e pagueshme, detyrimet ndaj paleve te lidhura, fondet nga Shoqeria Meme

Llogari te pagueshme, detyrime ndaj paleve te lidhura, fondet nga Shoqeria Meme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

TS

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

Vlera e drejte

Vlera e drejte e vleresuar per mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, te drejtat e arketueshme, llogarite e pagueshme, detyrimet ndaj paleve te lidhura, fondet nga Shoqeria Meje, i perafrohen vleres se tyre kontabel.

3.4 Inventari

Inventari perfshin materiale dhe pjese kembimi te blera dhe mbajtura me qellim per t'u perdorur ne operacionet e kerkimit dhe vleresimit. Ai njihet fillimisht me kosto dhe me vone vleresohet ne pasqyren e pozicionit financiar me vleren me te ulet mes koston dhe vleres se realizueshme neto. Kur materialet dhe pjeset e kembimit vihen ne perdorim, elementet perkates riklasifikohen si aktive kerkimi dhe vleresimi.

3.5 Kerkimi dhe vleresimi

Kostot e kerkimit dhe vleresimit, duke perfshire koston e blerjes se licenses dhe shpenzimet e pergjithshme administrative drejtperdrejt te lidhura me te, njihen si aktive materiale ose jo materiale te kerkimit dhe vleresimit ne varesi te natyres se aktivitetit te blere. Interesat dhe shpenzimet e tjera te financimit nuk kapitalizohen ne aktivet e kerkimit dhe vleresimit.

Njohja, matja dhe regjistrimi i aktiveve te kerkimit dhe vleresimit kryhen duke iu referuar Standardit Nderkombetar te Raportimit Financiar 6 "Kerkimi dhe Vleresimi i Burimeve Minerare". Standardet Kombetare te Kontabilitetit shqiptare lejojne referimin ne Standardet Nderkombetare te Kontabilitetit dhe Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar per trajtimin kontabel te elementeve te cilet nuk trajtohen ne menyre te posaqme dhe te mjaftueshme ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit shqiptare.

Shpenzimet qe lidhen me aktivitetet e kerkimit dhe vleresimit jane grumbulluar ne qendra kostosh ne baze pusesh, fushash dhe zonash eksplorimi ne pritje te percaktimit te pershtatshmerise teknike dhe tregtare.

Pershtatshmeria teknike dhe tregtare e nje license konsiderohet te jete e percaktueshme ne baze te disa treguesve, duke perfshire percaktimin e rezervave te provuara. Rishikimi i cdo license ose fushe kerkimi kryhet te pakten nje here ne vit, ne menyre qe te sigurohet nese projekti eshte i pershtatshem nga pikepamja teknike dhe tregtare. Pas percaktimit te pershtatshmerise teknike dhe tregtare te mjaftueshme, aktivet e kerkimit dhe vleresimit qe lidhen me keto rezerva, testohen per zhvleresim dhe pastaj ri-klasifikohen nga aktivet e kerkimit dhe vleresimit ne nje kategori te vecante brenda aktiveve afatgjata materiale si interesat e naftes.

3.6 Provizionet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i ngjarjeve te meparshme, Dega ka nje detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund te vleresohet me besueshmeri dhe do te kerkoje flukse dalese monetare te ardhshme per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset monetare te ardhshme te pritshme me nje norme skontimi para tatimit, e cila reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziket qe lidhen me detyrimin ne fjale.

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

3.7 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat njihen kur eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te lidhura me to do te vijne ne favor te Deges dhe kur vlera e tyre mund te matet ne menyre te besueshme. Te ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur rreziket dhe perfitimet thelbësore te lidhura me pronesine transferohen nga shitesi te bleresi. Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve njihen duke iu referuar fazes se perfundimit te transakcionit ne daten e raportimit.

3.8 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne fitime ose humbje.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet per interesa nga huate dhe humbjet nga kursi i kembimit. Te ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Ne baze te Ligjit nr. 7811, date 12.04.1994, i ndryshuar "Per miratimin me ndryshime te Dekretit nr. 782, date 22.02.1994 "Per sistemin fiskal ne sektorin e hidrokarbureve" tatimi mbi fitimin llogaritet ne baze te KNP-se se nenshkruar midis PMI dhe Ministrise se Energjise dhe Industrise, ne te cilen SUA eshte bere pale permes marrjes se 50% e me pas te 25% me teper te Interesit Punues. Ne baze te ketij ligji specifik, fitimet e tatueshme jane llogaritur ne baze te totalit te te ardhurave pas mbulimit/rikuperimit te te gjitha shpenzimeve operative dhe kapitale te kryera gjate periudhes se kerkimit dhe vleresimit, zhvillimit dhe prodhimit. Fitimet e tatueshme te llogaritura si me lart jane subjekt i tatimit mbi fitimin ne baze te normes specifike per kete industri ne nivelin e 50%. Raportet e rikuperueshmerise se kostove hidrokarbure dorezohen prane Agjensise Kombetare te Burimeve Natyrore ("AKBN") ne baza tremujore per miratim. Shpenzimet e rikuperueshme mbarten per nje kohe te papercaktuar deri ne rikuperimin e tyre te plote kundrejt prodhimit hidrokarbur.

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Tatimi mbi fitimin aktual dhe tatimi mbi fitimin i shtyre njihen ne fitim ose humbje me perjashtim te pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital, rast ne te cilin njihet ne kapital ose ne te ardhura te tjera gjithepershires.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore te caktuar ne KNP dhe ligjet specifike te industrise qe jane miratuar apo qe jane ne thelb te miratuara ne daten e raportimit, sic pershkruhet me lart, si dhe pas çdo sistemimi/regullimi te tatimit te pagueshem te lidhur me vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre njihet ne lidhje me diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel neto te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te raportimit financiar dhe shumave te perdorura per qellime tatimi.

Aktivi tatimor i shtyre njihet per kostot hidrokarbure te rikuperueshme por ende te parikuperuara, humbjet tatimore te paperdorura, kreditimet tatimore te paperdorura dhe diferencat e perkoheshme te zbritshme ne masen qe eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem do te jete i disponueshem kundrejt te cilit ato mund te perdoren. Aktivet tatimore te shtyra rishikohen ne çdo date raportimi dhe zvogelohen deri ne masen qe nuk eshte me e mundur qe te realizohen perfitimet perkatese tatimore.

TS

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)*

Aktivitet tatimore te shtyra te panjohura rivleresohen ne çdo date raportimi dhe njihen ne ate mase qe eshte bere e pritshme te kete fitime te tatueshme te ardhshme perkundrejt te cilave ato te mund te perdoren.

Tatimi i shtyre matet me normat e tatimit qe pritet te aplikohen ndaj diferencave te perkohshme kur ato te permbysen, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe konsiderohet si e tille ne daten e raportimit.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore te shtyra kompensohen nese plotesohen disa kritere.

4. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE TE TYRE

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Ne Leke	29,179	8,812
Totali	29,179	8,812

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perbehen vetem nga llogarite ne leke ne Raiffeisen Bank ne Shqiperi.

5. LLOGARI FINANCIMESH TE BRENDSHME

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari e perbashket financimi brenda grupit	752,644	3,897,626
Totali	752,644	3,897,626

Llogarite e financimit te brendshem konsistojne ne nje llogari te perbashket mjetesh monetare brenda grupit ne dispozicion te Deges. Nga vlera prej 752,644 Leke me 31 dhjetor 2015, 330,336 Leke perfaqesojne garanci prane Raiffeisen Bank per apelimet ne proces kundrejt dy rivleresimeve tatimore leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane gjate vitit 2015 (31 dhjetor 2014: zero).

6. TE DREJTA TE ARKETUESHME

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Te ardhura te perlllogaritura nga sherbimet profesionale sizmike	443,040	135,783
Totali	443,040	135,783

TS

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

7. AKTIVE TE TJERA AFATSHKURTRA

Aktivet e tjera afatshkurtra me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 perbehen nga sa me poshte:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Parapagime ndaj Ortakut ne		
Sipermarrje te Perbashket	227,934	-
Parapagime te tjera	9,152	3,017
Tatim fitimi i parapaguar	-	50
Totali	237,086	3,067

8. INVENTARI

Inventari me 31 dhjetor 2015 eshte ne vleren e 811,133 Leke dhe perbehet nga materiale dhe pjese kembimi qe priten te perdoren ne aktivitetet e kerkimit dhe te vleresimit (31 dhjetor 2014: 766,348 Leke).

9. AKTIVE KERKIMI DHE VLERESIMI

Aktivet e kerkimit dhe vleresimit me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 perbehen nga sa me poshte:

Kosto	Totali
Gjendja me 1 janar 2014	12,139,590
Shtesa	6,585,779
Gjendja me 31 dhjetor 2014	18,725,369
Shtesa	158,650
Gjendja me 31 dhjetor 2015	18,884,019

Aktivet e kerkimit dhe vleresimit perbehen nga projektet e Deges per aktivet jo materiale te kerkimit te cilat varen nga percaktimi i rezervave te provuara apo ato te mundshme. Shtesat paraqesin pjesen e shpenzimeve te Deges te kryera mbi aktivet e kerkimit dhe vleresimit pergjate vitit.

10. LLOGARI TE PAGUESHME

Llogarite e pagueshme me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 perbehen nga sa me poshte:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Llogari te tjera pagueshme te perllogaritura	122,818	270,031
Te pagueshme ndaj Ortakut ne	-	203,729
Sipermarrje te Perbashket		
Te pagueshme ndaj furnitoreve	18,855	21,872
Paga te pagueshme ndaj personelit	774	569
Totali	142,447	496,201

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)***11. DETYRIMET TATIMORE**

Detyrimet tatimore me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 perbehen nga sa me poshte:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi dhe sigurimet shoqerore e shendetesore	14,843	15,932
TVSH e pagueshme	2,127	4,086
Detyrime te tjera tatimore	2,388	3
Totali	19,358	20,021

12. DETYRIME NDAJ PALEVE TE LIDHURA

Detyrimet ndaj paleve te lidhura me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 perbehen nga sa me poshte:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Shell International Exploration and Production BV	265,072	95,546
Shell International Limited	186,354	38,366
Shell UK E&P-UK EU	58,972	13,112
Shell Finance BV	44,709	40,957
Shell Shared Service Centre Poland	11,482	-
Shell International BV	5,143	-
Shell Nederland BV	216	-
Shell Global Solutions	1	-
Totali	571,948	187,981

13. FONDET NGA SHOQERIA MEME

Me 31 dhjetor 2015, fondet nga Shoqeria Meme ne shumen prej 36,982,260 Leke (31 dhjetor 2014: ALL 33,877,620) perbehen nga nje financim afatgjate pa interes dhe rrjedhin pjeserisht nga nje kredi pa interes nga nje pale e lidhur me Shoqerine Meme dhe pjeserisht nga primi i aksioneve te kontribuar nga aksionari i Shoqerise Meme tek Shoqeria Meme.

14. TE ARDHURAT

Te ardhurat per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 jane ne shumen e 4,117 Leke (2014: 26,573 Leke) dhe perbehen nga te ardhurat te perlllogaritura nga shitjet e naftes se prodhuar gjate testimeve ne kuader te sherbimeve te studimeve sizmike.

TS

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)***15. SHPENZIMET E PERSONELIT**

Shpenzimet e personelit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 perbehen nga sa me poshte:

	2015	2014
Paga	435,518	317,991
Kosto te tjera te lidhura me personelin	176,298	76,909
Kontribute te sigurimeve shoqerore e shendetesore	30,013	6,183
Totali	641,829	401,083

16. SHPENZIME OPERATIVE

Shpenzimet operative per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 perbehen nga sa me poshte:

	2015	2014
Kosto te pergjithshme administrative	1,959,852	2,248,707
Kosto sizmike	104,563	88,991
Kosto te zhvillimit te biznesit	74,872	-
Rente minerare mbi naften e prodhuar gjate testimeve	358	2,267
Shpenzime te perlllogaritura garancie	-	40,957
Totali	2,139,644	2,380,922

Kostot te pergjithshme administrative perfshijne kosto te kryera ne mbeshtetje te aktiviteteteve te eksplorimit si sherbime finance, ligjore dhe konsulenca te tjera, menaxhim zyre, IT dhe telekomunikacion, sigurim, etj.

17. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzime te tjera per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 ne shumen 1,998 Leke perfshijne gjoba tatimore dhe interesa per pagese te vonuar te detyrimeve tatimore (2014: 616 Leke).

18. HUMBIA FINANCIARE NETO

Humbja financiare neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 analizohet si me poshte:

	2015	2014
Shpenzime financiare		
Humbje nga kursi i kembimit	(10,754,183)	(5,188,944)
Shpenzime interesi	-	(230)

TS

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015***(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)*

Komisione bankare	(295)	(257)
	(10,754,478)	(5,189,431)
Te ardhura financiare		
Fitime nga kursi i kembimit	8,019,164	2,158,284
Te ardhura nga interesat	575	12
	8,019,739	2,158,296
Humbja financiare neto	(2,734,738)	(3,031,135)

19. SHPENZIMI PER TATIMIN MBI FITIMIN

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin aktual dhe shpenzimi per tatimin mbi fitimin e shtyre per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 jane zero.

Norma tatimore efektive eshte zero ne krahasim me normen tatimore nominale prej 50% meqenese nuk ka fitim te taueshem pergjate ketyre viteve.

Me 31 dhjetor 2015 dhe 2014, nuk eshte njohur asnje aktiv tatimor i shtyre, si rezultat i pasigurive te fitime te tatueshme te ardhshme perkundrejt te cilave mund te perdoren.

20. TRANSAKSIONE ME PALET E LIDHURA

Nje permbledhje e transakcioneve dhe balancave me palet e lidhura eshte prezantuar si me poshte:

	2015	2014
Te arketueshme:		
Llogari financimesh te brendshme (shenimi 5)	1,135,386	644,795
Te pagueshme:		
Detyrime ndaj paleve te lidhura (shenimi 12)	571,948	187,981
Fonde nga Shoqeria Meme (shenimi 13)	36,982,260	33,877,620
Blerje:		
Shell International Limited	1,135,386	644,795
Shell International Exploration & Production	943,590	1,366,222
Shell UK E&P-UK EU	58,972	-
Shell Saudi Ventures	47,956	-
Shell Finance BV	44,709	-
Shell International B.V.	29,157	26,382
Shell Polska Sp Zoo Oddzial Wzarbierzowie	16,638	5,073
Shell Global Solutions	3,458	-
Nederlandse Aardolie Maatschappij BV	644	-
Shell Nederland BV	216	-

SHELL UPSTREAM ALBANIA B.V.– Dega ne Shqiperi

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015

(te gjitha shumat jane te shprehura ne mije Leke, pervec se kur percaktohet ndryshe)

21. NGJARJE PAS DATES SE RAPORTIMIT

Me 1 shkurt 2016, Shell Upstream Albania B.V. ka hyre ne nje marreveshje te shitblerjes me Petromanas Albania GmbH sipas te ciles ky i fundit pranon te caktoj, transferoje dhe percjelle drejt SUA pjesen e saj te interesit pjesemarres ne KNP ne Blloqet 2 dhe 3 ne toke ne Shqiperi, Marreveshjen e Perbashket Operative (se bashku me te drejtat perkatese te operimit) dhe Pronen e Perbashket, si dhe te drejten per te negociuar nje Kontrate me Ndarje Prodhimi per Bllokun 4 ne Shqiperi se bashku me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe kane te bejne me te ("Transaksioni"). Ne kuadrin e ketij Transaksioni, SUA ka blere pothuajse te gjithe aktivet e Petromanas Albania GmbH – Dega ne Shqiperi per nje shume bruto rreth 45 milione Dollare. Transaksioni i shitjes u finalizua me 31 mars 2016.

TS